



NJËSIA E BURIMEVE NJËRZORE

Nr. 13-111/01-0038577/25

Datë: 07.07.2025

Në bazë të nenit 78, paragrafi 2, nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197, në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), nenit 5, pikës c, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 (MASHT) të datës 18.06.2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe Rregullores (QRK nr. 19/24) si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të punës, Komuna e Podujevës shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi lirë/Zëvendësim	Paga: Klasa	Numri i pozitave
1.	IP	Edukatore 3-6	I lirë	5.2	2
2.	IP	Edukatore 3-6	Zëvendësim	5.2	2
3	SHFMU	Mësimdhënës/e për arsim fillor	I lirë	5.6	3
4	SHFMU	Mësimdhënës/e për arsim fillor	Zëvendësim	5.6	10
5	SHFMU	Mësimdhënës/e të Gjuhës Gjermane	I lirë	5.6	7

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë - Qendra për Shërbime me Qytetarë);
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);

- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat në vend të diplomës) të noterizuara;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore. (pas pranimi në punë)
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT
- Licencën e mësimdhënësit (për mësimdhënësit fillestar nuk kërkohet licenca me rastin e aplikimit në konkurs).
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 05/2021), si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për edukatore 3-6 vjeç:**
 - Fakulteti i Edukimit- programi katër vjeçar i nivelit bachelor për edukimin parashkollor;
 - Shkolla e Lartë Pedagogjike- drejtimi për edukatorë;
 - Fakulteti Filozofik- dega e pedagogjisë së përgjithshme;
 - Programi përkujdesje-mirëqenie e fëmijëve.
- **Kriteret e kualifikimit për mesimdhënës/e për arsim fillor**
 - Fakulteti i Edukimit-programi fillor;
 - Fakulteti i Mesuesisë.
 -
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS);

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Testit me shkrim, i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe ka në total 100 pikë,
- Intervista me gojë, pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portfolios, përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm

- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë.
- Pikët nga vlerësimi i portfolios, testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitë të lartëkura.
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të nostrifikojnë diplomat nga MASHT.
- Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartëkura.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, sepse nuk kthehen.

Afati i aplikimit: Koha e aplikimit është shtatë (30) ditë kalendarike nga data **08.07.2025** deri më datën **06.08.2025**. Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>

Mënyra e aplikimit: Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>) apo t'i shkarkojnë nga web-faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohet dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web-faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

Sqarim:

- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmëri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në këtë konkurs, por në varësi të lirimit të vendit të punës, (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë apo pushimeve tjera të rregulluara me ligj).

SHTOJCA 1. UDHËZIME PËR PËRGATITJEN E PORTFOLIOS PROFESIONALE

Portfolio Profesionale shërben si instrument për paraqitjen e përvojës dhe aftësive profesionale të fituara dhe zhvilluara nga shkollimi paraprak apo përvoja profesionale. Përvoja profesionale përfshinë përvojën si mësimdhënës në institucione shkollore duke përfshirë dëshminë e aktiviteteve të zhvillimit profesional.

Ndër të tjera, Portfolio profesionale mund të përfshijë:

- Biografinë.
- Licencën e mësimdhënësit (mësimdhënësit që kanë licencë) dhe certifikatat që dëshmojnë përfundimin e suksesshëm të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve si dëshmi tjera rreth realizimit të atyre programeve. Në portfolio vendosen certifikata të trajnimit, të fituara në programet e trajnimit nga fusha e mësimdhënies dhe të nxënit.
- Letër motivuese ose një ese personale të lidhur me mësimdhënien. Ky dokument reflekton parimet dhe vlerat që ka kandidati për mësimdhënien moderne dhe synimet për zhvillim në kontekst të zhvillimeve në sistemin e arsimit në Kosovë.
- Dëshmi për aktivitetet tjera në proceset e zhvillimit të arsimit (mund të jenë letër referencë apo certifikatë për pjesëmarrje në grupet punuese për zhvillimin e kurrikulave, udhëheqje të programeve të zhvillimit profesional, pjesëmarrje dhe kontribut në konferenca) etj.
- Dëshmi nga përvoja paraprake në mësimdhënie (shembuj të planeve të mësimit, shembuj të projekteve, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, kopje të punimeve, mirënjohje, etj).